



**PROJEKT – VENDIM**

Nr. 6187 Date 09.07.2018

**PER DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN E KESHILLIT  
BASHKIAK NR.11, DATE 29.01.2018 "PER MIRATIMIN E NIVELIT TE  
TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PER VITIN 2018" DHE NE  
VENDIMIN E KESHILLIT BASHKIAK NR.52 , DT.25.04.2018.**

Ne mbështetje te ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.9920, dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i propozoj Keshillit te Bashkise Lezhë miratimin e ndryshimeve në nivelin e Taksave dhe Tarifave si më poshtë:

**I.** Në kapitullin II ,në tabelën 12 "*Tarifa për zënien e hapësirave publike*".

Në pikën 1, sipas VKB nr.52, dt.25.04.2018 , tarifa për zënie hapësire publike për qellime biznesi ne trotuare (ku lejohet shfrytezimi i tyre), vendosje mallrash apo tavolinash, tezgash, vazosh, et., është 1000 Leke/m<sup>2</sup>/muaj, propozoj të bëhet 500 Lek/m<sup>2</sup>/muaj.

Ne rastin e subjekteve qe ushtrojne aktivitet ne trajten e tendave apo vendosje tavolinash në sipaerfaqe publike ne lulishte apo parqe, në këto raste të aplikohet tarifa 200 lek/m<sup>2</sup>/muaj.

**II.** Në kapitullin II. "*Tarifat e shërbimeve publike* "

*Pika II.9 "Tregtaret ambulante"*

Te behet nje specifikim për "Tregtaret Ambulante" që operojne ne shëtitoren "Willson"-Shengjin. Kjo tarifë per keta tregtare te behet 10,000 leke/vit (sezon). Kurse per tregaret e tjere ambulante që ushtrojnë aktivitet në vende të tjera kjo tarifë të mbetet 2,000 leke vit.

**III.** *Pika II.6 Tarifa e dhënies se lejeve per motorat e ujit*



Te shtohet nje pike per motorat e ujit dhe te aplikohet tarifa 50,000 lekë/mjet/sezon.

**IV.** Në "kreun 1.2 "Taksa mbi pasurine e paluajtshme"

**Pika I.1 Ndertese per qellime banimi**

Sipas VKM nr.132,date 07.03.2018 ,taksa mbi ndertesën për qellime banimi do te bazohet mbi çmimin referues te banesave,sipas tabelës ne aneksin nr.1 te ketij VKM. Per qytetet Lezhe dhe Shengjin taksa e banesës për qëllime banimi në VKB nr.52,dt.25.04.2018 është vendosur që kjo takes të jetë **28leke/m<sup>2</sup>/vit**.Ndersa për njësité e tjera administrative kjo takes te jete **20 Lek/m<sup>2</sup>/vit**.

I propozoj Këshillit Bashkiak që taksa e ndertesës per qellime banimi ne zonat qe kane kontrate me Ndermarrjen Ujesjelle-Kanalizime ShA,kjo takse te perfshihet ne faturen e ujit te pijshem per te gjithë klientet,duke perjashtuar ato qe me ligj perjashtohen nga pagesa e kesaj takse.

Per qytetin e Lezhes dhe njësité e tjera te shperndahet ne 5 keste te barabarta ,sipas sipërfaqes se banimit perkates.

Për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujesjelles-Kanalizime SHA,pagesa të kryhet pranë Njësive Administrative perkatese.

**V.**Ne kapitullin I.7 "taksa e perkohshme per arsimin"te perjashtohen nga pagesa e kesaj takse per tregtaret ambulante.

**VI.** Ne kapitullin I.4 "taksa e ndikimit ne infrastructure per ndertimet e reja" Ne tabelen nr.7 ne piken 1 taksa e ndikimit ne infrastrukture nga 7.6 % te behet 6 %.

**VII.** Ne kapitullin II.7 "Tarifa për shërbime në institucionet e Bashkisë" Tabela 18

Biblioteka Publike e qyteit:

Holli ne katin e II Ishte 7.000 Lek/ditë përdorimi Të bëhet 10.000 Lekë/ditë përdorimi

Holli në katin e III Ishte 3.000 Lek/ditë përdorimi Të bëhet 5.000 Lekë/ditë përdorimi

**KRYETARI**  
**Fran FRROKAJ**

